

KOLEGJI AAB
AAB COLLEGE
Prishtinë

Nr. 533/24 data: 31.07.2024



Kolegji AAB
CILËSI. LIDERSHIP. SUKSESI

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUÇITRAN

02 Nr. / Br 1300/24

Nr. i fq. / Br. sf _____

Data: / Datum 31-07-2024

VUSHTRRI - VUÇITRAN



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Kolegjit AAB

dhe

Komunës së Vushtrrisë

Duke u nisur nga interesi i përbashkët për avancimin e cilësisë së mësimdhënies e të shërbimeve arsimore në Kosovë. Bazuar në dëshirën për përparimin e shkëmbimeve arsimore në të mirë të rritjes së bashkëpunimit në mes të institucioneve arsimore në Kosovë, bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Kolegjit AAB dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës Nr.2855/117 të datës 13.12.2017 dhe atij Nr.510/24 të datës 24/07/2024. Me qëllim të krijimit të mundësive të reja të bashkëpunimit në dobi të studentëve, Kolegji AAB dhe Komuna e Vushtrisë (tutje në këtë dokument: Palët) lidhin këtë MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI sipas dispozitave në vijim:

Neni 1

Bashkëpunimi përfshinë por nuk kufizohet në:

- Promovimin e arsimit cilësor nëpërmjet të aktiviteteve të përbashkëta;
- Kryerjen e punës praktike për studentët e Kolegjit AAB në institucionet/departamentet, institucionet shëndetësore (QKMF), drejtoritë, agjencitë, institucionet shkollore dhe parashkollore të Komunës;
- Shkëmbimin e vizitave të organizuara tematike në dy drejtime nga nxënësit, studentët dhe mësimdhënësit;
- Bashkëpunim dhe fushata tematike ndër-institucionale për të mirën e përgjithshme si: mbrojtja e mjedisit, të drejtat e njeriut, shënimi i ditëve të ndryshme ndërkombëtare e kombëtare;
- Lehtësimi i implementimit të hulumtimeve e studimeve të ndryshme me rëndësi shoqërore, relevante për banorët dhe autoritetet e Komunës;
- Konkurimi i përbashkët në konkurse të ndryshme për projekte arsimore e hulumtuese në nivel komunal, kombëtar e ndërkombëtar;
- Organizimin e përbashkët dhe pjesëmarrjen në seminare, punëtori zhvillimore, e të tjera të karakterit rajonal e kombëtar në fushat e interesit të përbashkët;
- Organizimin e programeve të ndryshme nga ana e AAB-së për ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve dhe të institucioneve të Komunës;
- AAB do t'i ofrojë stafit pedagogjik të shkollave të Komunës, pjesëmarrje në konferenca shkencore pa pagesë;
- AAB do të ofrojë hapësira për shfrytëzim pa kompensim nëse kërkohet nga Komuna për ndonjë aktivitet të organizuar;
- AAB do të organizojë kurse pa kompensim në kampuset e AAB-se, të gjithë maturanteve për përgatitje të testit të maturës;

- Komuna i lejon AAB-se organizimin e sesioneve informative për programet e studimit të AAB-se në shkollat e komunës përkatëse.
- AAB do të ofrojë trajnime për stafin pedagogjik të shkollave varësisht nga kërkesa e Komunës në fushën pedagogjike, metodologjike të mësimdhënies, kurrikulës etj;
- AAB do të ofrojë qasje pa kompensim në Teatrin “Faruk Begolli” për aktivitetet teatrale që organizohen nga Teatri “Faruk Begolli” për të gjithë stafin pedagogjik të shkollave dhe stafin e Komunës që vijnë në mënyrë të organizuar;
- AAB organizon aktivitete sportive në hapësirat e AAB-së për nxënësit e shkollave;
- AAB sipas mundësive do të përkrahë bibliotekën e qytetit përmes dhurimit të librave të ndryshëm të botuar nga shtëpia botuese e AAB-së;

Neni 2

Kjo Marrëveshje bashkëpunimit krijon parakushtet për bashkëpunim të mëtejshëm dhe mund të nënkuptojë nënshkrimin e marrëveshjeve të tjera specifike për jetësimin e bashkëpunimit konkret në suaza të pikave të caktuara më lartë, për shembull në realizimin e punës praktike ose të ndërtimit të kapaciteteve.

Neni 3

Ekipe të përkatëse nga të dy institucionet do të angazhohen në konsultime përgatitore dhe do të takohen për të operacionalizuar aktivitete të ndryshme të përbashkëta.

Neni 4

Marrëveshja nënshkruhet për një periudhë pesë vjeçare nga momenti i nënshkrimit. Periudha e bashkëpunimit mund të vazhdohet me pajtim të ndërsjellë, përcjellë me nga një shkresë zyrtare nga të dyja palët dy muaj para skadimit të afatit të kësaj marrëveshjeje.

Neni 5

Palët mund të modifikojnë segmente të caktuara të bashkëpunimit me pajtim të ndërsjellë në një aneks-marrëveshje për vazhdimin e afatit të bashkëpunimit.

Neni 6


Marrëveshja nënshkruhet në dy kopje në gjuhën shqipe, ashtu që secila palë mban nga një kopje të marrëveshjes në origjinal.

Neni 7

Mospajtimet ose interpretime eventuale të ndryshme të pikave të kësaj marrëveshjeje do të rregullohen përmes negociatave të përbashkëta.

Kolegji AAB

Dr.Sc. Blerim Olluri
Rektor



Komuna e Vushtrisë

Z. Ferit Idrizi
Kryetar

